



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 5744 Prot

Peshkopi, më 14.12.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Zyra Arsimore Vendore Diber,

Prefekti i Qarkut Diber.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijjeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr.116

Datë: 06.12.2022

“Miratimi i linjave te transportit per zonat Peshkopi – Luzni Nj.A Luzni, Katund i Ri, Hotesh”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mirli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 116, date, 06/12 / 2022

“Miratimi i linjave të transportit për zonat Peshkopi-Luzni NJ.A Luzni, Katund i Ri, Hotesh”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, kërkesës së ardhur nga Federata e Sindikatave të Arsimit Dibër, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **06.12.2022** me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e linjave të transportit për zonat **Peshkopi-Luzni, NJ.A Luzni, Katund i Ri, Hotesh.**
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Taksave, Bashkia Dibër.
3. Njoftohet për vendimin e lartëcituar Zyra Arsimore Vendore Dibër dhe Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Vendimi u shpall me datë **06.12.2022**.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKË SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga
Redi Koli Sinjorovic Asimovic
date *27.10.2022* (me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) dhe mban nga dërguesi nr. *4095*)


Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. *4095* pr
date *27.10.2022*

- Praktika u drejtohet për administrim:
- Znj/z.
 - Znj/z. *Soldani E. Vahidi Besheq*
 - Znj/z.
 - Znj/z.

me porosinë:
Administrata praktike qytet. Dibër

Afati përgaditjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit
përpeshkruar do të jetë:
Sipas afatit
rënime nga nënpunësi/nënpunësit që përgaditen në praktikën (përgjigjen) shkresore:

NËNPUNËSI DËRGOJËS



FEDERATA E SINDIKATAVE TE ARSIMIT DIBER

LENDA KERKESE

DREJTUAR ZYRES ARSIMORE VENDORE DIBER, BASHKIA PESHKOPI (KESHILLIT BASHKIAK), QARKU DIBER.

Bashkia Peshkopi ka 41 shkolla 9-vjecare dhe te mesme te bashkuara. Ka 800 mesues te cilet jane nenshkruer te kontrates kolektive te punes. Kontrata kolektive e punes ne arsim eshte nje marreveshje e lidhur ndermjet Ministrise se Arsimit Rinise dhe Sporteve dhe sindikatave te arsimit. Ne kontrate jane pasqyruar te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kane mesuesit ndaj arsimit per ta bere ate sa me cilesor e funksional, pasi eshte shtylla me e forte qe mban ne kembet nje shtet.

Ne kontraten kolektive te punes Ministria e Arsimit ne bashkepunim me institucionin e zyres arsimore vendore dhe Bashkise Peshkopi, plotesimin e kushteve te punes per mesuesit dhe nxenesit, si sistemin e ngrohjes, lyerjen e shkollave, sigurimin e bazes materiale, veshtiresite e rruges dhe transportin e mesuesve. Transporti, pike e kontrates pothuajse eshte i zgjidhur.

Problem ngelet vetem linja Peshkopi-Luzni, Peshkopi-Katund i Ri, Peshkopi-Hotesh, pasi mesuesit levizin ne kete zone per te shkuar ne vendin e punes me mjete private dhe ne kushtet aktuale te rritjes se cmimeve dhe inflacionit, mesuesit e kane te pamundur per ta perballuar pasi duhet te heqin nga buxheti familjar nje pjese te rroges duke vene ne veshtiresi ekonomine e ketyre familjeve.

Prandaj ne emer te sindikatave te arsimit Diber i kerkojme institucioneve shteterore, Bashki (Keshilli Bashkiak), Qarku Diber, Zyra vendore arsimore Diber, te hap linjen e re te kesaj zone dhe mesuesit te paraqiten ne pune ne kushte normale si te gjitha mesuesit e tjere.

Jemi te bindur plotesisht qe institucionet e lartpermendura do te marrin ne konsiderate shqetesimin dhe problematiken e ketyre mesuesve qe punojne ne kete zone te larget.

Ju falenderojme per mirekuptimin dhe bashkepunimin!

Me respekt, Sindikata e Arsimit Diber

Kryetari

Selami Kaza

